



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 03-289
30.08.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark. nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022. Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative ark. nr.10-3036/1 datë 1.8.2023 dhe Konkluzionin ark. nr.02-3274/6, datë 29.8.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 28-të mbajtur më 29.8.2023 miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, për shkelje të kryer të nenit 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 7 korrik 2023, nuk ka ofruar informacion që duhet t'i vihet në dispozicion shfrytëzuesve.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3036 /1 datë 1.8. 2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet (konsiderohet) dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave në aspektin e harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akteve të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audio ose Audiovizuele për shfrytëzuesit e tyre duhet t'u ofrojnë qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme për të paktën në të dhënat e mëposhtme: emrin e ofruesit të Shërbimit Mediatik Audio ose Audiovizuele, gjegjësisht emërtimin, shenjën mbrojtëse ose shkurtesën e shenjës personale të identifikimit (avizo, logo, dhe të ngjajshme); adresën e selisë së ofruesit të Shërbimit Mediatike Audio ose Audiovizive; të dhëna për kontakt të ofruesit të Shërbimit Mediatik Audio ose Audiovizuale (numër telefoni, adresë të emailit dhe/ose uebfaqes, personi për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur dhe të organit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 31 korrik 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, transmetuar më 7 korrik,2023, në nivel rajonal, në të cilën ka konstatuar shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV. Gjegjësisht, me mbikëqyrje është konstatuar se me

datë 7.7.2023, SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve, përkatësisht nuk i ka ofruar sshfrytëzuesve të tij qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme të paktën në të dhënat e mëposhtme: emri i plotë i ofruesit të Shërbimit Mediatik Audiovizual; adresën e selisë së ofruesit të Shërbimit Mediatik Audioviziv; të dhëna për kontakt (numër telefoni, adresë të postës elektronike(email)) të ueb faqes; personit përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-3036/1 datë 1.8.2023 , e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) i LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë me datë 3.8.2023, i dërgoi Shkresë ark.nr.10-3036/2 datë 3.8.2023, me të cilën i ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3036/1 datë 1.8.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 7.8.2023.Në afatin e paraparë SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 29.8.2023 shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10- 3036/1 datë 1.8.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3274/6 datë 29.8.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur në 29.8.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmërohet SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrative përaqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10- 3036/1 datë 1.8.2023

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.